



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
DIVJAKË

Nr. 9157/Prot
8

Datë: 24/12/2024

VENDIM

Nr. 64 datë 24/12/2024

**MBI MIRATIMIN E KALENDARIT ORIENTUES PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE
VENDORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 datë 27/04/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 33 “Kalendari I programit Buxhetor Afatmesëm dhe I Buxhetit Vjetor” Pika 2 “Kalendari miratohet nga Këshilli I Njesisë së Vetqeverisjes Vendore jo më vonë se data 31 Dhjetor dhe hyn në fuqi në datën e parë të çdo viti buxhetor”.

Këshilli I Bashkisë Divjakë në mbledhjen e datës: 24/12/2024

VENDOSI:

I-Të miratojë Kalendarin orientues për menaxhimin e Shpenzimeve Vendore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

II-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori Juridik, Prokurimeve Publike dhe menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Infrastrukturës, Drejtoria e Bujqësisë, Mëdisit, Veterinarisë dhe Pyjeve, Sektori I Mirqënies Sociale dhe Përkujdesit Shoqëror, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brëndëshme, Sektori I Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shtëpi, Inspektoriati I Policise Bashkiake, Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Kulturës, Sportit dhe Arsimit, Agjensia e Shërbimeve Komunale, Njësitë Administrative Tërbuf, Grabian, Remas, Gradishtë.

III- Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
ANA NAKO**



BASHKIA DIVJAKË

KALENDARI ORIENTUES PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE VENDORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Dhjetor	Brënda muajit Dhje	Kryetari I NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm
Dhjetor	Deri-31 Dhjetor	Këshilli I Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm
Janar	15	Kryetari I NJQV-së	Kryetari Shpërndan kalendarin e programit buxhetor Afatmesëm tek të gjitha Njësitë Shpenzuese
Janar	31	Kryetari I NJQV-së	Kryetari I Njesisë paraqet për Shqyrtim dhe miratim raportin e vlersimit të të ardhurave dhe Shpenzimeve
Mars	3	Këshilli I Njesisë Vendore	Miraton Raportin e vlersimit të të ardhurave dhe shpenzimeve
Mars	Brënda datës 15	Kryetari I NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së Tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së
Mars	17	Këshilli I Njesisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm
Mars	24	Kryetari I NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së Buxhetit të Njesisë Vendore dhe e shpërndan tek njësitë shpenzuese
Mars-Prill	25 Mars - 25 Prill	Njësitë Shpenzuese të Bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre Buxhetore
Prill	28 Prill - 30 Prill	Njësia e Vetqeverisjes Vendore	Zhvillojnë takime Konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për PBA 2026-2028
Maj	1- 2 Maj	Njësitë Shpenzuese të Bashkisë	Njësitë Shpenzuese paraqesinnë Bashki kërkesat e përgatitura
Maj	5 Maj - 16 Maj	Njësia përgjegjëse për Buxhetin në Bashki	Kryejnë analizat e kërkesave Buxhetore
Maj	19 Maj - 23 Maj	Kryetari I NJQV-së	Organizon Seancat Dëgjimore me Banorët
Maj	26 Maj - 28 Maj	Kryetari I NJQV-së	Prezanton dokumentin e PBA 2026-2028 me shoqërinë Civile
Maj	29 Maj - 30 Maj	Njësia përgjegjëse për Buxhetin në Bashki	Përpilon draftin e fazës së parë të PBA-së 2026-2028
Qershor	?	Kryetari I NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave Projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave	Dërgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit Buxhetor Afatmesëm
Qershor	Deri - 25	Njësia përgjegjëse për Buxhetin në Bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri - 30	Këshilli I Njesisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari I NJQV-së	Merr masa për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 18 Korrik	Këshilli I Njesisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit Buxhetor Afatmesëm
Korrik	25	Kryetari I NJQV-së	Miraton Udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese
Korrik-Gusht	28 Korrik-29 Gusht	Njësitë Shpenzuese të Bashkisë	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	1	Njësitë Shpenzuese të Bashkisë	Njësitë Shpenzuese paraqesin në Bashki kërkesat Buxhetore të rishikuara
Shtator	2 Shtator-12 Shtator	Njësia përgjegjëse për Buxhetin në Bashki	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	Deri - 16	Kryetari I NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm të Rishikuar
Shtator-Tetor	Deri - 6 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njësitë e Vetqeverisjes Vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA 2026-2028
Tetor-Nëntor	9 Tetor-28 Nëntor	Njësia përgjegjëse për Buxhetin në Bashki	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2026 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2026-2028 dhe I paraqet për shqyrtim në Këshill
Dhjetor	25	Këshilli I Njesisë Vendore	Miraton Programin Buxhetor Afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor
Dhjetor	31	Kryetari I NJQV-së	Merr masa për publikimin e dokumentit të plotë të programit Buxhetor Afatmesëm

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

ANA NAKO